



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 55, Datë 02.04.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “TRUEN” SH.P.K. PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SAJ SI MJET PËR GARANTIMIN E
DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 9, pika 8 dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 186/3 prot., datë 29.03.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “TRUEN” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 30.01.2013, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 12, datë 30.01.2013.
- Me shkresën e protokolluar në Entin Rregullator të Energjisë me nr. 186 prot., datë 18.01.2024, ajo ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen barrës siguroese të radhës së parë mbi kuotat e shoqërisë “TRUEN” sh.a. nga “YLLIAD” sh.p.k. në favor të CN’Air, kjo si garanci për pagesën e Shtesës së Çmimit 1 dhe Shtesës së Çmimit 2, referuar përcaktimeve të Marrëveshjes për shitblerjen e aksioneve të shoqërisë “TRUEN” sh.p.k., nënshkruar më 01.06.2023, mes “YLLIAD” sh.p.k. dhe “CN’Air”, e ndryshuar.
- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 299, datë 19.10.2023, është vendosur dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k., ku ortakut i vetëm i shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. bëhet “YLLIAD” sh.p.k.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, me shkresën e ERE-s nr. 186/1 prot., datë 02.02.2024, i është evidentuar shoqërisë dokumentacioni i munguar i këtij aplikimi.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186/2 prot., datë 20.02.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.
- Pas analizimit të kërkesës dhe dokumentacionit rezultoi se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2021.
- Shoqëria “TRUEN” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “TRUEN” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
- Për shkak të natyrës që ka vendosja e një mjeti të tillë mbi kuotat për garantimin e detyrimit përkatës nga i licencuari, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë “TRUEN” sh.p.k., në favor të “CN’AIR”.
2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “TRUEN” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.
3. Shoqëria “TRUEN sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “TRUEN” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI